



## MISIONI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE (BE MVZ)

ZGJEDHJET KOMUNALE NË KOSOVË,\* 3 NËNTOR 2013

### DEKLARATË PRELIMINARE

Një hap pozitiv përpara për demokracinë në Kosovë

Prishtinë, 5 nëntor 2013

---

#### PËRMBLEDHJE

---

- Zgjedhjet e 3 nëntorit për kryetarë të komunave dhe për kuvendet komunale ishin zgjedhjet e para që u mbajtën në tërë Kosovën, përfshirë edhe katër komunat veriore me shumicë serbe, sipas ligjeve të Kosovës. Zgjedhjet pasuan nga marrëveshja e 19 prillit 2013 e arritur në mes të Prishtinës dhe Beogradit, me lehtësimin e Bashkimit Evropian. Mbajtja e zgjedhjeve për herë të parë në veri të Kosovës paraqiste sfida të veçanta për organizimin e tyre. Misioni i OSBE-së luajti një rol kyç në lehtësimin e zgjedhjeve në veri si dhe votimin jashtë Kosovës përmes postës në Serbi dhe Mal të Zi.
- Në pjesën më të madhe të Kosovës, Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe paqësore. Njerëzit shprehën të drejtën e tyre demokratike të votimit, duke përfshirë veriun, përkundër përpjekjeve në disa vende nga kundërshtarët e zgjedhjeve për t'i dekurajuar njerëzit nga votimi. Zgjedhjet në veri janë cenuar nga sulmet në tri qendrat të votimit në Mitrovicë të veriut, si dhe braktisja e procesit të zgjedhjeve në atë pjesë.
- Në pjesën më të madhe të Kosovës, ambienti i zgjedhjeve ishte i qetë dhe garuesit ishin në gjendje të zhvillonin fushatën lirshëm. Pretendimet se në disa rajone është ushtruar presion mbi punonjësit e shërbimit publik, përfshirë këtu edhe mësimdhënësit, për të marrë pjesë në manifestimet e fushatës u vlerësuan nga BE MVZ si të besueshme. Task Forca e udhëhequr nga Kryeprokurori ka ngritur disa raste të veprave që kanë të bëjnë me fushatën, sipas kodit penal, përfshirë këtu frikësimin dhe ofrimin e ryshfetit. Frikësimi dhe presioni i atyre që ishin kundër zgjedhjeve kundër aktivistëve politikë dhe votuesve në katër komunat veriore kanë kufizuar aktivitetet e fushatës për garuesit, duke krijuar një ambient të pafavorshëm për fushatë të lirë.
- Korniza ligjore ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në përputhje me normat ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar në Kushtetutën e saj. Ndryshimet në Kodin Penal e rrisin numrin e veprave penale që lidhen me zgjedhjet për të cilat parashihen dënime të ashpra.
- Duke pasur parasysh gjendjen e posaçme në veri, përgatitjet për zgjedhjet komunale janë kryer ndryshe në tërë Kosovën. Në shumicën e komunave dukej se përgatitjet teknike janë kryer pa vështirësi madhore. Megjithatë, përfshirja e popullatës serbe në veri si dhe serbët e zhvendosur ka ngritur shumë çështje komplekse dhe politikisht të ndjeshme.
- Ligji për zgjedhjet përfshin dispozita që garantojnë të drejtën e votuesve jashtë Kosovës për të votuar. Megjithatë, ky proces nuk ishte i favorshëm për votuesit dhe nuk ishte gjithëpërfshirës. Nga 41,168 aplikacione për votim jashtë Kosovës, mbi 39,000 ishin nga Serbia dhe Mali i Zi. Fillimisht, u aprovuan vetëm 8,383 e aplikacioneve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe pas ankesave u aprovuan edhe 5,458 të tjera.
- Ligji e përcakton kuotën minimale prej 30 për qind për të dy gjinitë për listat e subjekteve politike në zgjedhjet për kuvendet komunale dhe për numrin e ulëseve që eventualisht do të ndahen. Megjithatë, prej 224 kandidatëve për kryetarë të komunave, vetëm nëntë ishin femra.

---

\* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit dhe me Mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

- Mediat e mbuluan fushatën në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke ua bërë të mundur garuesve që t'i përcjellin mesazhet e tyre, si dhe duke u ofruar votuesve informata të larmishme për fushatat. Megjithatë, televizioni publik *RTK 1* shfaqti preferencë të qartë në prezantimin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në pushtet.
- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) i shqyrtoi ankesat që kishin të bënin me shkeljet e pretenduara të rregullave të zgjedhjeve sipas legjislacionit.

---

## KONSTATIMET PRELIMINARE

---

### INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Zgjedhjet e 3 nëntorit 2013 për kryetarë të komunave dhe për kuvende komunale ishin të një rëndësie të veçantë pasi që ishin zgjedhjet e para që mbaheshin në tërë Kosovën, përfshirë edhe katër komunat veriore me shumicë serbe, Mitrovicën, Leposaviqin, Zveçanin dhe Zubin Potokun, sipas ligjeve të Kosovës. Ato ishin vijim i marrëveshjes së 19 prillit 2013 të arritur në mes të Prishtinës dhe Beogradit, me lehtësimin e Bashkimit Evropian, e cila ndër të tjera, bënte thirrje për mbajtjen e zgjedhjeve komunale në këto katër komuna.

Kushtet për zgjedhje në veri ishin veçanërisht sfiduese. Institucionet e Kosovës nuk kishin ndikim atje dhe KQZ nuk mund të komunikonte drejtpërsëdrejti me Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ). Në këto rrethana, Misioni i OSBE-së në Kosovë luajti rol kyç në lehtësimin e pjesëmarrjes së popullatës serbe të Kosovës, duke ndihmuar në organizimin e zgjedhjeve në katër komunat veriore, si dhe votimin përmes postës jashtë Kosovës. Një fushatë e fuqishme kundër mbajtjes së zgjedhjeve e vështirësoi edhe më shumë ambientin për fushatë zgjedhore.

Nga subjektet pjesëmarrëse në këto zgjedhje, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), parti kjo në koalicionin qeveritar me numrin më të madh të përfaqësuesve në Kuvendin e Kosovës, po i mbronte 14 poste të kryetarëve të komunave, ndërsa partia opozitare Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) po mbronte shtatë, përfshirë edhe kryeqytetin, Prishtinën. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) po i mbronte postet në gjashtë komuna, kryesisht në pjesën perëndimore, ndërsa Vetëvendosje, e cila për herë të parë u përfaqësua në parlament më 2010, po merrte pjesë për herë të parë në zgjedhjet komunale. Partia Liberale e Pavarur (SLS), parti e serbëve etnikë e cila është pjesë e koalicionit qeverisës në nivel nacional, u përball me konkurrencë të fortë të Iniciativës Qytetare 'Srpska', e cila mbështetej nga disa parti me seli në Beograd, për t'i kontrolluar komunat me shumicë serbe. Në Graçanicë, në zgjedhje mori pjesë edhe një iniciativë e re qytetare, Aleanca e Serbëve të Kosovës (SKS). Shumë përfaqësues të partive politike këto zgjedhje i konsideronin si test para zgjedhjeve të ardhshme për Kuvendin e Kosovës.

### KORNIZA LIGJORE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Korniza ligjore ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në përputhje me normat ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar në kushtetutën e saj. Ndonëse Kosova nuk ka nënshkruar asnjë zotim ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ose për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, kushtetuta e saj e përcakton zbatimin e drejtpërdrejtë të disa marrëveshjeve dhe dokumenteve ndërkombëtare, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010 ishte themeluar një komision parlamentar me qëllim që të

propozonte një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse. Megjithatë, procesi i reformës nuk ka lëvizur që atëherë, dhe ndonëse janë bërë disa ndryshime lidhur me procedurat për ankesa dhe parashtresa, legjislacioni që rregullon zgjedhjet në thelb mbetet i pandryshuar.

Me ndryshimet e Kodit Penal në vitin 2012 është shtuar numri i veprave penale që lidhen me zgjedhjet dhe janë përcaktuar dënime më të ashpra. Këto dënime të ashpra të parashikuara, bashkë me fushatat e informimit publik të zhvilluara nga Task Forca e përbërë nga Zyra e Kryeprokurorit, Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor, KQZ dhe PZAP, si dhe me fushatën e organizatës së vëzhguesve vendorë, Demokracia në Veprim, kanë pasur për qëllim që t'i bëjnë njerëzit të përmbahen nga shkeljet zgjedhore.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton kuotën minimale prej 30 për qind për të dy gjinitë për listat e subjekteve politike për zgjedhjet për kuvendet komunale dhe për numrin e ulëseve që eventualisht do të ndahen. Gratë ishin shumë më pak të përfaqësuara si anëtare të KKZ-ve dhe të Komisioneve të Vendvotimeve (KVV).

Barazia e personave para ligjit dhe respektimi i të drejtave themelore të pranuar ndërkombëtarisht janë të mishëruara në legjislacionin e Kosovës. Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në autoritetet legjislative dhe ekzekutive të komunave është i garantuar. Anëtarët e KKZ-ve dhe KVV-ve duhet të pasqyrojnë përbërjen e komuniteteve në komunë. Megjithatë, Vëzhguesit afatgjatë kanë vërejtur se komunitetet e tjera pakicë përveç serbëve dhe shqiptarëve (aty ku serbët përbëjnë shumicën në komunë) nuk kanë qenë gjithnjë të përfaqësuar në përpjesëtim me numrin e tyre. Fushatat zgjedhore në përgjithësi kanë qenë të fokusuar në grupet etnike individuale dhe nuk kanë adresuar çështje që paraqesin shqetësim specifik për pakicat.

Votuesit me nevoja të veçanta kishin të drejtë të kërkonin votimin në shtëpi. Vetëm katër komunat veriore nuk iu përmbajtën afatit kohor për këto kërkesa. Për të verbrit ishte vënë në dispozicion votimi në alfabetin e brajlit.

#### **ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE**

Duke marrë parasysh kushtet e veçanta në katër komunat veriore, përgatitjet administrative për zgjedhjet komunale kanë qenë të ndryshme në tërë Kosovën. Në shumicën e komunave, përgatitjet teknike duke se kanë shkuar pa ndonjë pengesë të madhe. Megjithatë, përfshirja e popullatës serbe në veri dhe e serbëve të zhvendosur ngriti shumë çështje komplekse dhe politikisht të ndjeshme që duhej të trajtoheshin nga Misioni i OSBE-së në Kosovë në kuadër të rolit të tij lehtësues.

Zgjedhjet u administruan nga një administratë zgjedhore në tri nivele e cila kryesisht përbëhej nga përfaqësuesit e partive më të mëdha politike. Derisa KQZ është organ i përhershëm, 38 KKZ-të dhe rreth 2,400 KKV-të ishin emëruar vetëm për këto zgjedhje. Kryesuesja e KQZ-së ishte zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Dhjetë anëtarët e KQZ-së ishin caktuar nga gjashtë grupet më të mëdha parlamentare në Kuvendin e Kosovës, katër nga të cilët përfaqësonin komunitetet pakicë.

Përkundër pretendimeve se KQZ është shumë e politizuar, anëtarët e KQZ-së dukej se punonin në mënyrë kolegjiale gjatë periudhës së veprimtarisë së BE MVZ-së. Përgatitjet për zgjedhje ishin të centralizuara dhe vëzhguesit raportuan se disa KKZ kishin kritikuar nivelin e mbështetjes që kishin marrë nga Sekretariati i KQZ-së. KKZ-të kishin praktika të ndryshme të punës. Disa mbanin takime të shpeshta formale ndërsa të tjerët takoheshin joformalisht dhe nuk mbanin procesverbale. Përveç atyre

në komnatat veriore, KKZ-të ishin funksionale dhe gëzonin besimin e palëve kryesore të interesit në këto zgjedhje.

Misioni i OSBE-së kishte rol kyç në organizimin e zgjedhjeve në katër komnatat veriore duke ndihmuar në operacionet zgjedhore dhe në mbajtjen e kontakteve ndërmjet KQZ-së dhe KKZ-ve atje. Përkundër shumë sfidave, infrastruktura për zgjedhje siç është përgatitja e listave të votuesve dhe përgatitja e vendvotimeve u bë me sukses. Megjithatë, kompleksiteti dhe ndjeshmëria politike e procesit në veri medoemos ndikoi në transparencën e përgatitjeve për zgjedhje në ato komuna, duke krijuar perceptimin e pasigurisë dhe mungesës së qartësisë. Disa anëtarë të KQZ-së e kritikuan rolin e OSBE-së për mungesën e informacioneve për përgatitjet në veri si dhe për votimin jashtë Kosovës, të shkaktuar nga mungesa e një mekanizmi raportues formal. Megjithatë, pas kërkesës me shkrim nga KQZ, me 31 tetor Misioni i OSBE-së i dorëzoi një raport lidhur me asistencën e saj në procesin zgjedhor.

KQZ nuk arriti t'u përmbahet disa afateve kohore operacionale dhe ligjore, kryesisht që kanë të bëjnë me paraqitjen publike dhe certifikimin e listave të votuesve. Përdorimi i simboleve shtetërore të Kosovës në materialet zgjedhore ishte çështje kontestuese. Përderisa KQZ arriti një marrëveshje për heqjen e simbolit nga fletëvotimi, ai vazhdoi të mbetet në listat e votuesve, në formularët e rezultatit dhe dokumentacionin tjetër zyrtar zgjedhor. Kjo krijoi një paqartësi pak para zgjedhjeve për atë nëse do të pranoheshin këto dokumente në komnatat veriore. Edukimi i votuesve u intensifikua në televizion gjatë ditëve të fundit para zgjedhjeve.

## **REGJISTRIMI I VOTUESVE**

KQZ ishte përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe azhurnimin e listave të votuesve të cilat ishin nxjerrë nga Regjistri Qendror Civil (që mbahet nga Ministria e Brendshme). Besimi në saktësinë e listave të votuesve ishte i ulët, veçanërisht për shkak të rasteve të shpeshta kur në to gjendeshin njerëzit që tashmë kishin vdekur si dhe për shkak të numrit të madh të votuesve që jetonin jashtë vendit. Për zgjedhjet komunale të vitit 2013 kishte rreth 1.8 milionë votues, duke përfshirë edhe rreth 66,000 në komnatat veriore.

Personat me të drejtë vote që përkohësisht jetonin jashtë vendit, ose që ishin zhvendosur nga Kosova kishin të drejtë të regjistroheshin dhe të votonin me postë. Për këtë janë pranuar 41,168 aplikacione, përfshirë edhe mbi 39,000 nga Serbia dhe Mali i Zi. Fillimisht, vetëm 8,383 e këtyre aplikuesve u aprovuan nga KQZ si votues. Sipas KQZ-së, të tjerët u refuzuan për shkak të dëshmimeve të pamjaftueshme që ishin paraqitur për të vërtetuar se këta aplikues kishin jetuar në Kosovë para 1 janarit 1998. Gjithsejtë 16,355 aplikues të refuzuar i parashtruan ankesë PZAP-së. Nën presion të madh kohor, paneli i PZAP-së prej dhjetë anëtarësh ia doli t'i shqyrtojë këto ankesa dhe vendosi t'i lejojë edhe 5,458 të tjerë.

Procesi i regjistrimit jashtë Kosovës ishte shumë i vështirë dhe nuk ishte as i përshtatshëm për votuesit e as gjithëpërfshirës. Aplikuesit duhej ta dëshmonin të drejtën e tyre duke paraqitur kopje të vjetra të letërnjoftimeve, pasaportave, patentë shoferëve, faturave të shërbimeve komunale, etj., të lëshuara në Kosovë. Megjithatë, kjo ishte e vështirë për shumë aplikues pas më shumë se 15 vitesh. Së dyti, afati kohor për regjistrim jashtë Kosovës ishte jashtëzakonisht i shkurtër duke pasur parasysh faktin se Misioni i OSBE-së duhej t'i bartte të gjitha aplikacionet, vendimet dhe ankesat duhej të barteshin në Serbia dhe anasjelltas, dhe t'u dërgoheshin votuesve përmes postës së Serbisë. Për më tepër, BE MVZ pranoi informata të besueshme se verifikimi i aplikacioneve nga KQZ nuk ishte gjithmonë konsekuent

dhe i bazuar në kriteret objektive, dhe se herë pas herë korrespondenca u dërgohej votuesve në adresa të pasakta.

## REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Regjistrimi i kandidatëve është bërë në mënyrë gjithëpërfshirëse. KQZ certifikoi 103 subjekte politike (parti politike, koalicionet, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur) për të garantuar në zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe për kuvendet komunale. Gjithsejtë 7,926 kandidatë ishin certifikuar për të garantuar për 38 kuvendet komunale, një e treta e të cilëve ishin femra. Vetëm nëntë nga 224 kandidatët për kryetarë të komunave ishin femra. Disa kandidatë për kryetarë të komunave janë aktualisht të akuzuar për krime të ndryshme, disa prej të cilëve për krime lufte.

## AMBIENTI I FUSHATËS

Në pjesën më të madhe të Kosovës, me një përjashtim të dukshëm të katër komunave veriore, fushata zgjedhore u zhvillua në një atmosferë të qetë dhe garuesit ishin në gjendje të zhvillonin fushatën lirisht. Periudha e zyrtare e fushatës filloi me 3 tetor. Përveç bërjes së fushatës përmes mediave, garuesit mbajtën tubime dhe takime të vogla, si dhe zhvilluan fushata derë-më-derë dhe shpërndanë fletushka. Garuesit po ashtu përdoren edhe mediat sociale për të lajmëruar për manifestimet e fushatës dhe për reklama me pagesë. Partitë më të fuqishme në Kuvendin e Kosovës ishin ato që u vërejtën më së shumti. Përkundër faktit se këto ishin zgjedhje lokale, në to mbizotëruan udhëheqësit nacionalë dhe çështjet nacionale. Kandidatët për kryetarë të komunave u vërejtën më shumë se sa kandidatët për kuvendet komunale. Premtimet e Kryeministrit për financim të konsiderueshëm për komunat ku ai bëri fushatë u kritikuan shumë nga garuesit e tjerë.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme e përmban Kodin e Sjelljes në fushatë, të cilin ishin të obliguar ta respektonin të gjithë garuesit në zgjedhje, ndërsa shkeljet duhej të sanksionoheshin nga PZAP. Ky Kod, mes tjerash, ndalon çdo lloj frikësimi ose dhune nga subjektet politike, si dhe blerjen e votës. Pavarësisht këtyre ndalesave, në disa rajone ka pasur akuza se është ushtruar presion mbi punonjësit e shërbimit publik, përfshirë punonjësit shëndetësorë dhe mësimdhënësit, si dhe nxënësit, për të marrë pjesë në manifestimet e fushatës së partisë që e kishte pushtetin në komunë. BE MVZ i ka vlerësuar rastet në komunat e Prishtinës, Skenderajt, Malishevës, Lipjanit, Gjakovës, Graçanicës, Killokotit dhe Leposaviqit si të besueshme. MBEZV pranoi akuza për blerje të votave në shkallë të gjerë, veçanërisht në ditën para zgjedhjeve. Kishte indikacione se në shënjestër për blerje të votës ishte popullata rome në Mitrovicën Jugore dhe në Graçanicë.

Vendosja e afisheve të fushatës është dëshmuar mjaft kundërthënëse. Në disa zona, garuesit pretendonin se partitë që qeverisnin në nivel lokal ishin favorizuar gjatë ndarjes së billbordeve komerciale. Kodi i Sjelljes e ndalon vënien e afisheve në vende të caktuara, si në institucione publike, shenja të trafikut, etj., si dhe largimin apo dëmtimin e afisheve. PZAP-së i janë parashtruar një numër i madh i ankesave për shkeljen e këtyre rregullave, e në shumë raste janë shqiptuar gjopa. Si demonstrim pozitiv i përkushtimit për zbatimin e të drejtave zgjedhore, prej përfundimit të fushatës, Task Force e udhëhequr nga Kryeprokurori i Shtetit i ka iniciuar 16 raste sipas kodit penal për shkeljet që kanë të bëjnë me fushatën, përfshirë frikësimin dhe blerjen e votës.

Në katër komunat veriore, mbizotërimi në shkallë të gjerë i frikësimit dhe presionit kundër aktivistëve politikë dhe votuesve kufizoi aktivitetet e fushatës së garuesve në këto zgjedhje, duke krijuar një ambient të pafavorshëm për fushatë të lirë. BE MVZ i analizoi rastet e presionit mbi disa persona që të

mos marrin pjesë në fushatë, dhe i vlerësoi ato si të besueshme. Fushata kundër pjesëmarrjes në zgjedhje u vërejt shumë më tepër se sa fushatat zgjedhore të garuesve në zgjedhje. Afishet e atyre që merrnin pjesë në zgjedhje shpesh u grisën. Ambienti për fushatë në Leposaviq ishte më pozitiv. Tri mjete shpërthyes gjatë javës së 14 tetorit kishin në shënjestër personalitete që ishin kandidatë ose kishin tërhequr kandidaturën e tyre më herët. Natën e 1 nëntorit u sulmua fizikisht kandidati i Iniciativës Qytetare 'Srpska' për kryetar të komunës së Mitrovicës Veriore. Më 2 nëntor u vra kandidati i AAK-së në Skenderaj, edhe pse kjo nuk dukej se kishte të bënte me zgjedhjet. Vizitat e zyrtarëve të Beogradit në komunat me shumicë serbe i shtuan kundërthëniet.

## **MEDIA**

Në përgjithësi, mediat u ofruan subjekteve politike mënyra të ndryshme për ti përcjellë mesazhet e tyre te elektorati, dhe u ofruan votuesve informata të shumta për t'u mundësuar atyre të bëjnë zgjedhje të informuar. Gjatë periudhës së fushatës u respektua liria e shprehjes e cila garantohet me Kushtetutë. Megjithatë, në një rast negativ, kryeredaktorja e gazetës Kosova Sot ishte kërcënuar pas një foto-raportimi kritik që kishte të bënte me komunën e Prishtinës.

Fushata kishte paraqitje mjaft të madhe në mediat nacionale, duke përfshirë edhe numrin shumë të madh të spoteve me pagesë dhe transmetimin e drejtpërdrejtë të tubimeve, mbulimin e gjerë në lajme dhe debatet e shumta që zhvilloheshin për komunat e ndryshme. Mediat i kushtuan vëmendje të posaçme fushatës në Prishtinë. Ndonëse edhe komunat e tjera u mbuluan rregullisht nga mediat, paraqitja në lajme në masë të madhe varej nga prania e udhëheqësve të partive, e jo nga aktivitetet e kandidatëve komunalë apo nga temat lokale.

Komisioni i Pavarur për Media (KPM), përgjegjës për mbikëqyrjen e mediave transmetuese gjatë fushatës, pranoi nëntë ankesa zyrtare. Fakti se Komisioni përbëhet nga të emëruar politikë ndikoi në punën e tij. Dy nga shtatë anëtarët e tij nuk ishin emëruar fare për shkak të mosmarrëveshjeve politike, dhe dy të tjerë u kritikuan se kishin marrë pjesë në fushatën zgjedhore. MVZ u informua se sipas monitorimit të mediave nga Zyra Ekzekutive e KPM-së, mediat, përfshirë edhe transmetuesit publikë, i kishin respektuar kushtet për ndarjen e kohës.

Shumica e mediave të monitoruara i kishin mbuluar më së shumti subjektet më aktive politike. PDK ishte mbuluar më së shumti në shumicën e mediave në gjuhën shqipe. Në emisionet e veta të lajmeve, Televizioni Publik *RTK 1* demonstroi një preferencë të dukshme në paraqitjen e PDK-së, posaçërisht udhëheqësit të saj, Kryeministrit. Televizioni privat *TV21* u ofroi shikuesve të vet një portretizim të balancuar të garuesve, ndërsa në disa media të tjera, si në televizionin nacional *KTV* dhe në gazetën *Koha Ditore*, mbulimi i PDK-së ishte me ton më kritik. Të dy kanalet transmetuan edhe programe dhe debate analitike shumë cilësore.

Nga dy kanalet televizive private në gjuhën serbe të cilat u monitoruan, *TV Most* shfaqti një anim në favor të Iniciativës Qytetare 'Serbe'. Kanali televiziv publik në gjuhën serbe *RTK 2* pati një mbulim të balancuar, përfshirë edhe në debate, të garuesve që përfaqësonin votuesit serbë, malazezë dhe boshnjakë.

## **KONTESTET ZGJEDHORE**

Procesi i ankesave dhe parashtresave realizohet nga PZAP, i cili është organ i pavarur i përbërë nga 10 gjyqtarë. Ndaj vendimeve të tij mund të parashtrahet ankesë në Gjykatën Supreme. Paneli shqyrtoi ankesat për shkeljet e pretenduara të rregullave të fushatës si dhe mori vendime për ankesat që kishin

të bënin me vendimet e KQZ-së. PZAP i procedoi parashtrirat dhe ankesat në pajtim me rregullat, duke analizuar dëshmitë dhe në shumicën e rasteve duke respektuar afatet kohore. Megjithatë, ai nuk mbajti asnjë seancë dëgjimore për t'u mundësuar paditësve ose të paditurve që t'i paraqesin qëndrimet e tyre. Gjatë periudhës zyrtare të fushatës, shumica e ankesave kishin të bënin me shkeljet e pretenduara të Kodit të Sjelljes nga pjesëmarrësit në zgjedhje. Paneli po ashtu shqyrtoi ankesat kundër vendimeve të KQZ-së. Ndryshimet në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme përcaktuan afate kohore me realiste si dhe rritën gjatësi të mundshme për shkeljen e rregullave zgjedhore. Megjithatë, mungesa e një afati të qartë ligjor për të marrë vendim për ankesat që nuk kanë të bëjnë me votimin ose numërimin bënë që PZAP-së t'i duhet më shumë kohë për të adresuar disa ankesa.

Sa i përket votimit jashtë Kosovës (shih pjesën për Regjistrimin e votuesve), rreth 5,100 aplikues të cilëve PZAP-ja ua kishte refuzuar ankesën parashtruan ankesë në Gjykatën Supreme. Megjithatë, pasi që shqyrtimi i ankesave u kushtëzua me një pagesë prej 30 eurosh dhe koha që kishte mbetur deri në zgjedhje ishte shumë e shkurtër, këto ankesa nuk do të mund të shqyrtoheshin me kohë për tu mundësuar këtyre personave të merrnin pjesë në zgjedhje. Si rezultat i kësaj, u shkel e drejta në ushtrimin e mjeteve juridike efektive kundër vendimeve gjyqësore, si dhe nuk u respektua e drejta e këtyre personave për të votuar.

## VËZHIMI VENDOR

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton mundësinë për vëzhgim vendor dhe ndërkombëtar të zgjedhjeve. Vëzhguesit e subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje dhe të organizatave të shoqërisë civile u akredituan nga KQZ në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke rritur kështu transparencën e procesit. U akredituan pothuajse 27,000 vëzhgues që përfaqësojnë subjektet politike. Demokracia në Veprim, një koalicion i organizatave të shoqërisë civile, e ka vëzhguar tërë procesin zgjedhor dhe në ditën e zgjedhjeve i ka shpërndarë vëzhguesit në tërë Kosovën. Dega e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) në Kosovë i ka shpërndarë vëzhguesit në disa lokacione të zgjedhura në ditën e zgjedhjeve. Institucioni i Avokatit të Popullit po ashtu ka shpërndarë vëzhguesit e vet, duke u përqendruar në procesin e votimit të personave që gjenden në institucione si spitale, qendra të shëndetit mendor, burgje dhe qendra të paraburgimit. Koalicioni për Monitorimin e Zgjedhjeve i përbërë nga nëntë organizata të shoqërisë civile të komunitetit serb, ka shpërndarë vëzhguesit në komunat me shumicë serbe. Disa prej aplikacioneve të tyre për akreditim ishin refuzuar nga KQZ sepse nuk kishin pasur letërnjoftime të Kosovës.

## VOTIMI DHE NUMËRIMI

Në pjesën më të madhe të Kosovës, Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe paqësore, pa incidente të mëdha. Votuesit dolën në vendvotime për ta shprehur të drejtën e tyre demokratike të votimit, duke përfshirë në katër komunat veriore, përkundër përpjekjeve në disa vende nga kundërshtarët e zgjedhjeve për t'i dekurajuar njerëzit nga votimi. Afër fundit të Ditës së zgjedhjeve, sukcesi i zgjedhjeve në veri është cenuar nga sulmet në tri qendrat të votimit në Mitrovicë të veriut, që çuan në heqjen dorë nga procesi i zgjedhjeve në atë pjesë. Kutitë e votimit nga komunat tjera të veriut janë dërguar në një lokacion në jug, përkundër shqetësimeve të sigurisë gjatë bartjes në disa raste.

BE MVZ ka vëzhguar hapjen, votimin, mbylljen dhe numërimin në 460 vendvotime në tërë Kosovën. Hapja dhe votimi janë vlerësuar me nota pozitive apo të kënaqshme në shumicën dërmuese të vendvotimeve të vëzhguara. Përderisa integriteti i votës duket të jetë mbrojtur në nivel të mjaftueshëm

në shumicën e vendeve, ka pasur raste të izoluara të shkeljeve të rënda, duke përfshirë raste të votimit të shumëfishtë, kërcënimit dhe fotografimit të fletëvotimeve gjatë votimit. Fshehtësia e votës nuk është respektuar gjithmonë dhe në një numër të konsiderueshëm të vendvotimeve në tërë Kosovën është vërejtur prania e më shumë se një personi në kabinë të votimit, kryesisht si pasojë e votimit familjar.

Ka pasur mungesë konsistence në atë nëse për të votuar duhet të pranohen dokumentet identifikuese të Serbisë apo UNMIK-ut. Në prag të zgjedhjeve, KQZ-ja ka nxjerrë udhëzime të cilat saktësonin dokumentet identifikuese që do të përdreshin, por nuk sqaronin nëse ato përfshijnë dokumentet identifikuese të Serbisë, gjë që ka çuar në huti tek stafi i KVV-ve në disa raste.

Në përgjithësi, numërimi ka kaluar pa parregullsi të mëdha, ndonëse në disa raste janë vërejtur disa gabime procedurale. Një numër i fletëvotimeve janë shpallur të pavlefshme për zgjedhjet për Kuvende Komunale, si duket, për shkak të udhëzimeve të paqarta për anëtarët e KVV-ve, si dhe informimit të dobët të votuesve.

Në intervale të rregullta kohore gjatë Ditës së Zgjedhjeve, Task Forca e udhëhequr nga Kryeprokurori ka ofruar informata të reja lidhur me numrin e lëndëve të hapura penale për shkelje të së drejtës zgjedhore, me qëllim që të parandalimit të veprave që kanë të bëjnë me zgjedhjet. PZAP ka pranuar ankesa që kishin të bënin me votimin dhe numërimin dhe ka informuar BE MVZ-në se nuk do të shqyrtohen ankesat të cilat gjithashtu hetoheshin nga policia.

---

*Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë (MBEZV) filloi punën me 4 tetor 2013. Misioni udhëhiqet nga Shefi i Misionit Roberto Gualtieri, deputet i Parlamentit Evropian. MBEZV ka shpërndarë në tërë Kosovën gjithsejtë 99 vëzhgues nga të 28 vendet anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra për të vlerësuar tërë procesin zgjedhor në pajtim me zotimet ndërkombëtare për zgjedhje, si dhe me ligjet e Kosovës. Këtij misioni iu bashkuan edhe dy anëtarë të Parlamentit Evropian të cilët në tërësi e pranuan këtë deklaratë. MBEZV mbështetet në Deklaratën e Parimeve për Vëzhguesit Ndërkombëtarë të Zgjedhjeve, të nënshkruar në selinë e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 2005. MBEZV dëshiron t'i shpreh mirënjohjen e vet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe autoriteteve të tjera, partive politike, shoqërisë civile dhe organizatave të mediave për bashkëpunimin dhe ndihmën gjatë vëzhgimit. MBEZV i është mirënjohëse edhe Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë dhe misioneve diplomatike të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian për mbështetjen e tyre.*

*Kjo deklaratë preliminare publikohet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve pjesërisht do të varet nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, përfshirë edhe llogaritjen e rezultateve dhe zgjidhjen e parashtrësive dhe ankesave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. MBEZV do të qëndrojë në Kosovë deri pas rëndit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, dhe raportin përfundimtar me rekomandime të hollësishme do ta publikojë brenda dy muajve nga përfundimi i procesit zgjedhor.*

*Ky raport është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, por zyrtar është vetëm versioni në gjuhën angleze. Një version elektronik i kësaj Deklarate Preliminare mund të shkarkohet në faqen e internetit të Misionit [www.eueom.eu/kosovo2013](http://www.eueom.eu/kosovo2013). Për më shumë informata dhe kërkesa për intervista, ju lutem kontaktoni me Florence Marchal, Zyrtare për Media dhe Komunikim me Publikun, Mobil: +386 49 73 77 08 – [florence.marchal@eueomkosovo2013.eu](mailto:florence.marchal@eueomkosovo2013.eu)*